REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 1574 Prot. Durrës, më 27.10.2022

**VENDIM**

**Nr. 62 Datë 27/10/2022**

**PËR**
**NJË SHTESË NË REGJISTRIN E PARASHIKIMEVE TË PROÇEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, PËR VITIN KALENDARIK 2022"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar regjistrit të parashikimit të proçedurave të prokurimeve publike për vitin kalendarik 2022, miratuar me vendim të Bordit të Administrimit Nr.7 datë 18.02.2022 me Nr. 308/5 Prot datë 18.02.2022, Shkresës Nr. 870/6 Prot datë 07.10.2022 me objekt " Kërkesë për studim projektim" të Sektorit të Investimeve, për procedurat e prokurimit " Studim projektim për rikonstruksionin tërësor të Godinës Qëndrore të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës" dhe "Punime për mirëmbajtjen dhe përshtatjen në godinat e kampusit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës"si dhe në kërkesën me Nr. 1483 Prot. datë 10.10.2022 të Administratorit " Për një shtesë në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin kalendarik 2022", Senati Akademik në mbledhjen e datës 27.10.2022,

**VENDOSI:**

**1.** Ti propozojë Bordit të Administrimit shtimin e objektit të prokurimit në regjistrin e parashikimit të prokurimit publik të vitit kalendarik 2022 për procedurat e ndara sipas përcaktimeve si më poshtë:

- Studim projektim për Rikonstruksionin Tërësor të Godinës Qëndrore të Universitetit "Aleksandër Moisiu ", Durrës me fond limit 1,766,404.14 (një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e katër pikë katërmbëdhjetë) lekë pa Tvsh;

- Studim projektim për punime për mirëmbajtjen dhe përshtatjen e ambjenteve në godinat e Kampusit të Universitetit "Aleksandër Moisiu ", Durrës me fond limit 1,490,991 (një milion e katërqind nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një ) lekë pa Tvsh.

**2.** Burimi i Financimit do të jetë : Të ardhurat e Institucionit.

**Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.**

**KRYETAR**

**Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI**

Adresa: Lagja Nr.1, Rr "Taulantia", Durrës, Tel: +355 52 39161, www.uamd.edu.al,